

**Dhoma e Avokatëve Tiranë**

**Av. Henrik Ligori**

*Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Torre "Drin", Nr. 62 - Licenca № 6321 - NUIS L821070330*

## **KËRKESË**

### **KËRKUESIT:**

- 1. Arben Ahmetaj**, i biri i Nevruzit dhe Ferdanes, lindur në Gjirokastrë më 28.06.1969, banues në adresën rruga "Kongresi i Lushnjës", Nd.5, H. 10, Njësia administrative nr.7, 1023, Tiranë,  
(*Nr. telefoni, adresa email-it të kërkuarit dhe/ose të avokatit*)
- 2. Erjola Hoxha**, e bija e Flamurit dhe e Teutës, lindur në Tiranë më datë 06.05.1980, banuese në të njëjtën adresë.

*të përfaqësuar nga Av. Henrik Ligori dhe Av. Ardian Visha, anëtarë të Dhomës së Avokatëve Tiranë, përkatësisht, me prokuraturat nr. 343 rep., nr. 233 kol., datë 14.03.2023 dhe nr. 342 rep., nr. 232 kol., datë 14.03.2023.*

*Njoftimet për kërkuarit të kryhen në adresën: Studio ligjore "Salati – Ligori", Rr. "Abdi Toptani", Torre Drin, nr. 62, 1001, Tiranë; tel. +355 69 206 0634, e-mail: henrik.ligori@gmail.com.*

### **SUBJEKT I INTERESUAR:**

**PROKURORIA E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

### **OBJEKTI I KËRKESËS:\***

**Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i urdhërit Nr.42, datë 28/03/2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe i vendimit Nr. 00 – 2023 – 762 i Vendimit, datë 11.05.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.**

## **Dërgimin e çështjes në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 43, në lidhje me nenin 17, 131/f, 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;  
Neni 13 i KEDNJ-së;  
Neni 77 i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Para: **GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

### **I. PARAQITJA E FAKTEVE:**

Më 22.02.2023, z.Adriatik Doçi kallëzoi në Prokurorinë e Posaçme disa fakte, për të cilat pretendoi se ishte vënë në dijeni për shkak të detyrës si gazetar dhe që, sipas tij, përbënin fakte penalisht të dënueshme. Sipas tij, në kryerjen e tyre, ishte përfshirë ish-Ministri i Financave, ish-Zëvendëskryeministri dhe deputeti i Kuvendit të Shqipërisë z.Arben Ahmetaj. Mbi bazën e këtij kallëzimi dhe dokumenteve bashkëlidhur tij, Prokuroria e Posaçme regjistroi **procedimin penal nr. 30, më 24.2.2023**, për krimet e parashikuara nga **nenet 260, 257/a dhe 287 të KP**.

Ndërkohë, para asaj Prokurorie, **më 19.9.2022** pati qenë regjistruar procedimi penal nr. **277/1**. Aktet e tij ishin veçuar nga aktet e procedimit penal nr. 277 i vitit 2020 (procedim i dërguar për gjykim) dhe prokuroria po hetonte për krimin e shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga **neni 248 i KP**, për fakte që lidhen me procedurën e kalimit për miratim në Këshillin e Ministrave të një projekt-vendimi të propozuar nga Ministria e Mjedisit (shndërruar më pas në VKM nr. 907, datë 17.12.2014), mbi bazën e të cilit u miratua sigurimi i financimit të një kontrate konçesioni, për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të qarkut të Elbasanit dhe prodhimin e energjisë, në favor të shoqërisë Albtek Energy sh.p.k. Objekt i hetimeve të këtij procedimi ishin, gjithashtu, fakte që lidheshin me disa pretendime për akte të paligjshme, të kryera nga funksionarë të Ministrisë së Industrisë dhe Energjisë, si dhe të institucioneve të tjera, për shkak se mbështetën propozimin e Ministrisë së Mjedisit për të ndjekur procedurën e tenderimit “negociim pa shpallje” dhe sepse dyshohej për mungesë të kontrollit në zbatimin e kontratës konçesionare.

Më 30.01.2023, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nxorri një urdhër, me anën e të cilit krijoi një grup hetimor prokurorësh për hetimin e këtij procedimi, ku përfshiu edhe z. Altin Dumani si pjesë e grupit, së bashku me prokuroren zj. Enkeleda Millonai.

Më 24.02.2023, procedimet penale nr. 277/1 dhe nr. 30, me urdhër të prokurorit, u bashkuan në një procedim të vetëm, në kuadër të të cilit hetohen fakte që lidhen me veprat penale të parashikuara nga **nenet 248, 260, 257/a dhe 287 të KP.**

Më 17.03.2023, prokurorët urdhëruan që z. Arben Ahmetaj t'i atribuohet cilësia e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, në kuadër të këtij procedimi, për veprat penale të parashikuara nga **nenet 260, 257/a dhe 287 të KP.**

Pikërisht, në kuadër të hetimeve të këtij procedimi të bashkuar, mbi kërkesë të Prokurorisë së Posaçme, me vendimin nr. 114 akti, datë 08.03.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, vendosi lejimin e kontrollit personal dhe të pasurive të paluajtshme (banesave) të disa personave, ndër ta, edhe të znj. Erjola Hoxha, e lidhur në bashkëjetesë me deputetin e Kuvendit të Shqipërisë, z. Arben Ahmetaj. Kryerja e kontrolleve në fjalë përligje nga qëllimi për *“...gjetjen dhe sekuestrimin e provave materiale që lidhen me veprat penale për të cilat ka filluar procedimi penal”* (pika 10 e dispozitivit të vendimit).

Përveç kontrollit personal të znj. Hoxha (pika 7 e dispozitivit të vendimit), Gjykata e Posaçme lejoi edhe kontrollin e pasurisë së paluajtshme me nr. 1/110, vol. 12, faqja 26, ZK 1925, apartament, me sipërfaqe trualli 521,13 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 98 m<sup>2</sup>, ndodhur në NB Hamallaj, e identifikuar edhe si vila nr. 22, Sapphire, të cilën ajo e pati blerë ligjërisht nga shtetasi Gerian Kuka, sipas kontratës me Nr. 1778 Rep. dhe Nr. 812 Kol., datë 31.03.2022.

Vendimi nr. 114 akti, datë 08.03.2023 u apelua nga mbrojtja e kërkuesve në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Shkaqet e ankimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit, mund të përmblihen në vijim:

1- Pakushtetshmëria dhe paligjshmëria e kërkesës dhe e vendimit për lejimin e kontrollit, pa autorizimin e Kuvendit të Shqipërisë, ndërkohë që në atë banesë bashkëjetonte me zj. Hoxha i hetuari z. Arben Ahmetaj, deputet i Kuvendit të Shqipërisë; pra, vendimi ka cenuar vullnetin e sovranit, të mishëruar në ligjin themeltar të Republikës (neni 73, par. 2) dhe normën e KPP (neni 288.1);

2- Vendimi nr. 114 akti, datë 08.03.2023 që lejoi kontrollin e banesës në pronësi të znj. Hoxha, ku ajo bashkëjeton me z. Arben Ahmetaj, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, është një akt i marrë në tejkalim të kompetencës funksionale të gjykatës *ratione personae*, pasi Gjykata e Posaçme nuk ka tagra që të autorizojë kontrollin e banesës së deputetit; kjo e drejtë i përket Kuvendit. Në këtë

këndvështrim, në kryerjen e këtij akti, ajo nuk i përmbushte kushtet e një “gjkate të krijuar me ligj” (neni 42, par.2);

3- Paligjshmëria e vendimit të kontrollit për shkak të mungesës së shkaqeve të ligjshme për kryerjen e tij dhe për mungesë arsytimi të lidhjes mes provave për kryerjen e faktit penal dhe sendeve që synohej të gjendeshin në banesë;

4- Paligjshmëria e procedurës së ekzekutimit të vendimit për lejimin e kontroleve, për shkak të shoqërimit me detyrim të znj. Hoxha, në dhunim të së drejtës së saj për liri e siguri, si dhe cenimit të së drejtës së saj për t’i garantuar dinjitetin njerëzor dhe privatësinë e komunikimeve, të mbrojtur nga nenet 25 dhe 36 të Kushtetutës dhe, përkatësisht, nenet 3 dhe 8 të KEDNJ-së.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me urdhërin nr.42, datë 28/03/2023, vendosi:

*“Mospranimin për shqyrtim të ankimit ndaj vendimit n. 114, datë 08/03/2023 të kolegjit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ngritur në fazën e hetimeve paraprake nga z.Arben Ahmetaj dhe nga znj.Erjola Hoxha”...*

Kundër këtij vendimi, kërkuesit paraqitën rekurs në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar mohimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të drejtës për ankim efektiv kundër shkeljeve të ligjit procedural, me pasojë cenimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr. 00 – 2023 – 762 i Vendimit, datë 11.05.2023, vendosi:

*“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga shtetasit Arben Ahmetaj dhe Erjola Shehu<sup>1</sup>, kundër vendimit nr. 42, datë 28.03.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit.”*

**II. LEGJITIMIMI I KËRKUESVE** (neni 71/a i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar)

a) Kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor për të cilin ka ngritur pretendime para Gjykatës Kushtetuese, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje, që lidhet me të drejta kushtetuese themelore (shih par. II/d).

b) Kërkuesit e kanë respektuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit të së drejtës; vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë daton 11.05.2023.

c) Kërkuesit plotësojnë, gjithashtu, kriterin e shterimit të mjeteve ligjore para Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe para Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Për të mbrojtur të drejtat

<sup>1</sup> Mbiemri “Shehu” është një gabim material i Kolegjit Penal; mbiemri i saktë është “Hoxha” (saktësimi ynë).

e shkelura, kërkuesit nuk kanë mundësi tjetër, përveçse t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, me anën e ankimit individual.

ç) Kërkuesve u është cenuar e drejta për akses në gjykatë dhe e drejta për ankim efektiv ndaj vendimit gjyqësor në një gjykatë më të lartë, të garantuara nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës. Këto të drejta lidhen me të drejta të tjera kushtetuese, të cilat kërkuesit i pretenduan me ankim para gjykatave dhe të cilat nuk u shqyrtuan në themel, sikundër janë e drejta e privatësisë së banesës së deputetit, e cila nuk mund të kontrollohet pa vendim të Kuvendit (neni 73, par.2), e drejta e zj. Hoxha për liri e siguri, si dhe të drejtat e saj për t'i garantuar dinjitetin njerëzor dhe privatësinë e komunikimeve, të mbrojtur nga nenet 25 dhe 36 të Kushtetutës Gjithashtu, shkeljet e pretenduara kanë cenuar të drejtën e kërkuesit Ahmetaj për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj (neni 42, par.2); Gjykata e Posaçme nuk ka qenë e tillë sepse i mungonte kompetenca funksionale për të vendosur kontrollin e banesës së deputetit pa autorizim paraprak nga Kuvendi. Këto të drejta mund të rivendosen duke deklaruar pakushtetutshmërinë e vendimeve të kundërshtuara dhe duke u krijuar mundësi kërkuesve për akses në gjykatë dhe për ankim efektiv ndaj vendimit gjyqësor.

### **III. PRETENDIMET NË LIDHJE ME SHKELJET KUSHTETUESE**

#### **A. Për pakushtetutshmërinë e vendimit gjyqësor që kufizoi të drejtën e aksesit në gjykatë dhe të drejtës për ankim efektiv të kërkuesve, për t'u ankuar ndaj një vendimi që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese të tyre.**

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në thelb, vendosi mospranimin e apelit me argumentin se vendimi nr. 114, datë 08.03.2023 nuk është “vendim”, por “urdhër” i nxjerrë në fazën e hetimeve paraprake dhe, si i tillë, është i paankimueshëm. Pra, ajo Gjykatë nuk mori në shqyrtim thelbin e shkeljeve që pretendohet se cenonin të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesve.

Të njëjtit argument i qëndroi edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për të vendosur mospranimin e rekursit. Sipas Kolegjit, vendimi për autorizimin e kontrollit të banesës së znj. Erjola Hoxha, ku ajo bashkëjetonte me z. Arben Ahmetaj, deputet i Kuvendit, nuk është një vendim përfundimtar, që zgjidh thelbin e akuzave ndaj kërkuesit, ndaj si i tillë ai është vendim i paankimueshëm (par. 30-31). Kolegji Penal iu referua parimit të taksativitetit të ankimit, duke qenë se neni 202 i KPP parashikon të drejtën e ankimit vetëm për prokurorin (në rast rrëzimi të kërkesës për kontroll), por jo edhe të drejtën e personit nën hetim për t'u ankuar (par. 26).

Mbrojtja e kërkuar vlerëson se pengimi i së drejtës së ankimit ndaj një vendimi gjyqësor që lejon kontrollin e banesës së personit, është mohim i së drejtës për akses në gjykatë dhe për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë, i mbrojtur posaçërisht nga nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës së RSH dhe nga neni 13 i KEDNJ<sup>së</sup>, në lidhje me nenin 8 të saj, për arsyet e mëposhtme:

Kushtetuta parasheh raste përjashtimore kur e drejta e ankimit në lëndë penale mund të kufizohet, por vetëm "... për kundërvajtje të lehta penale, ..., në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës." (neni 43, par.2). Nëse juridiksioni do të kufizonte ankimin ndaj vendimeve që cenojnë sovranitetin e organit ligjvënës, banesën dhe privatësinë e saj, privatësinë e komunikimeve, të drejtën e mbrojtjes, etj., atëherë subjektet e prekura do të ngeleshin pa mbrojtje efektive ndaj disponimeve të paligjshme të gjykatës. Pra, në rastin konkret nuk jemi para kushteve përjashtimore dhe nuk plotësohet rregulli i proporcionalitetit që vendos neni 17, par. 1 i Kushtetutës.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk mbajti parasysh, as normën e nenit 17, par.2 të Kushtetutës, e cila sanksionon që "kufizimet e lirive dhe të drejtave në asnjë rast nuk mund të prekin thelbin e tyre dhe as të tejkalojnë kufizimet që vendos KEDNJ<sup>ja</sup>."

Konventa Europiane Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore garanton të drejtën për zgjidhje efektive nga juridiksioni gjyqësor kombëtar<sup>2</sup>. Në rastin e kontrollit të banesës, realizimi efektiv i garancisë që parashikon neni 13, e lidhur kjo me garancitë e nenit 8 të Konventës, sipas këndvështrimit të GJEDNJ<sup>së</sup>, ankimi do të ishte efektiv, nëse ankuesi do të kishte akses në një procedurë që "... i lejon të kundërshtojë ligjshmërinë e kontrollit dhe të sekuestrimit të kryer në vijim të tij." (shih [Posevini kundër Bullgarisë, 2017, par. 83-87](#)).

Në rastin objekt i kësaj kërkesë, znj.Erjola Hoxha dhe z.Arben Ahmetaj, të lidhur në bashkëjetesë, legjitimoheshin *ratione personae* për të apeluar vendimin nr. 114 akti, datë 08.03.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, në funksion të së drejtës për një zgjidhje efektive. Ata janë persona të cilave, sikundër parashtruar më sipër, **iu cenuan të drejta të mbrojtura nga Kushtetuta dhe KEDNJ<sup>ja</sup>, të cilat nuk kanë ku t'i mbrojnë përveçse përpara juridiksionit gjyqësor.** Kjo e drejtë atyre iu mohua, si nga Gjykata e Posaçme e Apelit, ashtu edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Përfundimisht, pretendojmë se **e drejta e aksesit në gjykatë dhe e drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor para një gjykate më të lartë nuk mund të kufizohet në rastet kur vendimi gjyqësor cenon sovranitetin e organit ligjvënës, banesën dhe privatësinë e saj, privatësinë e**

<sup>2</sup> Neni 13 E drejta për zgjidhje efektive. Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

komunikimeve, të drejtën e mbrojtjes apo të drejta të tjera themelore të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndaj Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën kushtetuese të kërkuesve për t'u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

#### **IV. KËRKESA PËRFUNDIMTARE**

Në përfundim, kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese:

- 1- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të urdhërit Nr.42, datë 28/03/2023 dhe të vendimit Nr. 00 – 2023 – 762 i Vendimit, datë 11.05.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për shkak të cenimit të së drejtës së kërkuesve për akses në gjykatë dhe për ankim efektiv ndaj një vendimi që prek të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese.**
- 2- Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.**

#### **V. LISTA E DOKUMENTEVE BASHKËLIDHUR**

1. Vendim Nr. 114 akti, datë 08.03.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
2. Apel i vendimit Nr. 114 akti, datë 08.03.2023 i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
3. Urdhër Nr.42, datë 28/03/2023 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
4. Rekurs i urdhërit Nr.42, datë 28/03/2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
5. Vendim Nr. 00 – 2023 – 762 i Vendimit, datë 11.05.2023 i Kolegjit Penal i Gjykatës të Lartë;
6. Prokurë e posaçme nr. 343 rep., nr. 233 kol., datë 14.03.2023;
7. Prokurë e posaçme nr. 342 rep., nr. 232 kol., datë 14.03.2023.

**Për kërkuesit:**

*Arben Ahmetaj*

*Erjola Hoxha*

**Mbrojtësit:**

Av. Henrik Ligori

Av. Ardian Visha